VENDIM
Nr. 122, datë 9.11.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN "PËR INSTRUMENTET E PAGESAVE ELEKTRONIKE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "b; nenit 21 dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe të nenit 4, pika 47, nenit 126 dhe nenit 129, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe të Departamentit të Sistemeve të Pagesave dhe Kontabilitetit e Financës,

VENDOSI:

1. Pika 5 e nenit 27 të rregullores "Për instrumentet e pagesave elektronike", miratuar me vendimin nr. 11, datë 6.2.2008, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të ndryshohet si më poshtë:

"Kufijtë minimalë dhe maksimalë, brenda të cilëve emetohet paraja elektronike, përcaktohen në kontratën e emetimit të parasë elektronike, të parashikuar në pikën 4 të këtij neni."

2. Ngarkohet Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe Kontabilitetit e Financës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gent Sejko